

VENDIM
Nr.163, datë 18.3.2004

**PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË DËMEVE SHKAKTUAR PRONËS SË
PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE, GJATË KRYERJES SË DETYRËS OSE PËR
SHKAK TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 28 e 30 të ligjit nr.9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton kompensim, sipas paragrafit të dytë të nenit 28 të ligjit nr.9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, kur vërtetohet se:

- i është shkaktuar dëm në pasurinë e paluajtshme ose të luajtshme;
- ky dëmtim apo shkatërrim është bërë gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;
- punonjësi i Policisë Ushtarake është pronar a bashkëpronar i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, objekt i dëmtimit;
- shkaktuesi i dëmit është dënuar, në mungesë ose është shpallur i pamundur për të shlyer detyrimin civil, me vendim gjykate të formës së prerë.

2. Kompensimi të jetë në masën 100 për qind të dëmit të shkaktuar. Ky kompensim jepet në lekë.

3. Ministri i Mbrojtjes kur mendohet për raste të dëmtimit të pronës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ngre menjëherë një grup pune për hartimin e procesverbaleve për vlerësimin e gjendjes dhe të dëmit.

4. Ministri i Mbrojtjes nxjerr urdhrin e dëmshpërblimit, pasi shqyrton procesverbalet për vlerësimin e gjendjes dhe të dëmit, administron vendimin e gjykatës për përcaktimin e shkakut të dëmtimit të pronës dhe të masës së këtij dëmtimi (nëse gjykata e ka përcaktuar këtë masë), si dhe vërtetimin e pronësisë së punonjësit të Policisë Ushtarake, të dëmtuar.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano